



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-112/02-15455
Datë: 04.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 38 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 46 të Rregullores numër 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Vlerësimit për zhvillimin e procedurës RN00012248 të lëvizjes brenda kategorisë për pozitën **Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm**.
2. Komisionin e Vlerësimit nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
 - 2.1. Dervish Tahiri – Kryesues (Drejtor i Qendrës për Punë Sociale)
 - 2.2. Frrok Gjergjaj – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit Ligjor)
 - 2.3. Avdyl Nuraj – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit)
 - 2.4. Zymber Berisha – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit për Arsim)
 - 2.5. Teuta Krasniqi – Anëtare (Zyrtare e Lartë e Burimeve Njerëzore)

Zëvendësues të anëtarëve të komisionit:

- 2.1. Engjëll Berisha – Kryesues (Drejtor i Bibliotekës Publike “Ibrahim Rugova”)
 - 2.2. Qazim Mehmeti – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë)
 - 2.3. Gani Rama – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit të Financave)
 - 2.4. Dardan Krypa – Anëtarë (Udhëheqës i Sektorit për Teknologji Informativë)
 - 2.5. Jeta Haraçia – Anëtare (Zyrtare e Burimeve Njerëzore)
3. Komisioni i Vlerësimit fillon punën gjatë fazës së përgatitjes për intervistimin e kandidatëve të paraqitur, dhe shpërbëhet menjëherë pas përfundimit të procedurës së rekrutimit.

A r s y e t i m

Komisioni është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, mbajtjen e testeve të përzgjedhjes, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshëm.

Me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këto vende të punës, u caktua komisioni si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës